
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	<b>ZYRA E PERSONELIT          KANCELARIJA OSOBLJA</b>		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.83 /18	Data: 21.05.2018	

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 3 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Istogut nxjerr :

### SHPALLJE E REKRUTIMIT

**Institucioni:** Komuna e Istogut

**Drejtoria:** Drejtoria për Arsim dhe Kulturë

**Titulli i vendit të punës :** Drejtor i Qendrës Kulturore

**Numri i Referencës :** RN00003222

**Numri i ekzekutuesve:** 1 ( një )

**Lloji i pozitës:** I karrierës

**Orari i plotë:** 40 orë në javë

**Kategoria Funktionale:** Niveli Drejtues

**Grada:** Niveli I koeficient ( koeficienti 9.5 )

**Kohëzgjatja e emërimit:** Pa afat

**Qëllimi i vendit të punës:** Udhëheqja dhe mbikëqyrja e shërbimeve kulturore.

**Detyrat dhe Përgjegjësit :**

1. Udhëheq me Qendrën për Kulturë;
2. Merr pjesë dhe ndihmon të gjitha aktivitetet dhe manifestimet që zhvillohen në kuadër të komunës;
3. Përcjell punët profesionale kulturore në nivel komunal e më gjerë;
4. Angazhohet dhe përkrah të gjitha shoqëritë kulturore dhe shoqatat e të rinjve si në mënyrë profesionale, ashtu edhe në aspektin financiar brenda buxhetit të lejuar;
5. Menaxhon dhe mbikëqyrë projekte të ndryshme kulturore;
6. Bashkëpunon me udhëheqësit e të gjitha shoqërive kulturo-artistike në nivel komunal e më gjerë;
7. Pranon të gjitha aktet dhe shkresat nga DAK-ja, si dhe i regjistron dhe i shpërndan sipas dedikimit;
8. Për punën e vet i përgjigjet drejtorit të drejtorisë.

**Shkollimi i kërkuar:** - Diplomë Univerzitare, katër (4) vite përvojë menaxheriale - drejtuese.

**Kushtet e pjesëmarrjes në Rekrutim :**

Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.

**Procedura e konkurimit:** Procedura e konkurimit është e hapur për kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

**Shkathtësitë:** Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim. Të jetë i gatshëm të punoj nën presion.

**Afati i konkursit :** Konkursi është i hapur pesëmbdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit.

**Dokumentet e kërkuara :** Diploma mbi kualifikimin, diplomat e lëshuara nga institucionet shkollore jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i, dëshmi për përvojën e punës, dokumenti i identifikimit, ekstrakti i lindjes. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (të punësuarit ), si dhe certifikata tjera mbi trajnimet. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës..

**Paraqitja e kërkesave :** Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr. 100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

*“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë “*

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Menaxheri i Personelit  
Fatmir Bytyçi

